



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

---

## BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË TURQI

### VITI AKADEMIK 2020-2021

Në kuadër të programit ndërkombëtar të bursave, qeveria turke ofron bursa studimi universitare/ pasuniversitare ose në fushën e kërkimit për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në universitetet turke për vitin akademik 2020-2021.

Kriteret bazë për aplikimin që duhet të plotësojnë kandidatët:

- Të jenë shtetas të huaj;
- Të jenë nën moshën 21 vjeç për programet universitare;
- Të jenë nën moshën 30 vjeç për programet e Masterit;
- Të jenë nën moshën 35 vjeç për programet e Doktoratës;
- Të plotësojnë kriteret akademike të përcaktuara nga universitetet;
- Të jenë të diplomuar ose në fund të vitit aktual akademik (para shtatorit 2020).

Për programet e studimit që do të zhvillohen në gjuhën turke, kandidatët do t'i nënshtrohen vitit përgatitor të gjuhës turke. Në disa universitete, programe të veçanta studimi mund të ndiqen edhe në gjuhën angleze ose frënge. Kusht për fillimin e studimeve në këto gjuhë është dhënia e provimit ndërkombëtar dhe certifikimi për njohjen e gjuhës së huaj (SAT, TOEFL, DELF, YDS).

Procedurat e seleksionimit për fituesit e bursave realizohen nga universitetet turke. Bursa e studimit mbulon të gjitha shpenzimet e ushqimit, të akomodimit, si dhe tarifën e shkollimit. Studenteve të përzgjedhur do t'iu jepet edhe një bursë mujore në varësi të programit akademik të përzgjedhur.

Lidhur me afatet e aplikimit, kandidatët do t'i referohen kalendarit të aplikimeve në faqen e publikimeve në web për bursat e ofruara në programe për studime universitare ose pasuniversitare. Aplikimi plotësohet vetëm në sistemin online. Kandidatët duhet të paraqesin dhe të ngarkojnë dokumentet e nevojshme në sistemin e aplikimit që gjendet në faqen online <https://turkiyeburslari.gov.tr/en/page/prospective-students/how-to-apply>.

Pala turke nënvizon se nuk do të pranohen aplikimet e dërguara me postë.

Afati i fundit për aplikimin *online* është data **20 shkurt 2020**.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit, të kriterëve, përgatitjes së dokumentacionit, referojuni adresave të mëposhtme në web-site:

<http://www.turkiyeburslari.gov.tr>;

<https://turkiyeburslari.gov.tr/en/page/prospective-students/scholarship-programs>

<https://turkiyeburslari.gov.tr/en/page/prospective-students/application-criteria>;

<https://turkiyeburslari.gov.tr/Content/20019-calendar.pdf>;

e-mail: [info@turkiyeburslari.org](mailto:info@turkiyeburslari.org).

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**